
ZYRA NDËRKOMBËTARE E PUNËS

Programi i Punësimit në Shqipëri

Projekti ALB/03/50/ITA

“Asistencë për forcimin e sistemit të punësimit
dhe formimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit
të Shqipërisë”

**TË DHËNA PARAPRAKE NGA SONDAZHI
PËR ZBULIMIN E AFTËSIVE TË KËRKUARA
NË NDËRMARRJET E VOGLA DHE
MIKRO-NDËRMARRJET NË SHQIPËRI**

Zyra Ndërkombëtare e Punës
Zyra nënrajonale për Evropën Qendrore dhe Lindore, Budapest

Të dhëna paraprake nga sondazhi për
zbulimin e aftësive të kërkuara në
ndërmarrjet e vogla dhe
mikro-ndërmarrjet në Shqipëri

Zyra Ndërkombëtare e Punës
Shërbimi Kombëtar i Punësimit i Shqipërisë

Parathënie

Materiali “Të dhëna paraprake nga sondazhi për zbulimin e aftësive të kërkuara në ndërmarrjet e vogla dhe mikro-ndërmarrjet në Shqipëri” u hartua për të mbështetur institucionet e tregut të punës në vend të identifikojnë aftësitë që po kërkohen në tregun e punës. Objektivi i këtij sondazhi është mbledhja e të dhënave bazë për të hartuar programe dhe shërbime punësimi që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës.

Ky raport përmban të dhëna paraprake nga sondazhi i nevojave për aftësi që u krye nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit gjatë periudhës Dhjetor 2008 – Shkurt 2009. Kjo veprimtari u ndërmor në kuadër të Projektit ILO “Asistencë për forcimin e sistemit të punësimit dhe formimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit të Shqipërisë” që financohet nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme.

Tabelimi i të dhënave të sondazhit u koordinua nga Znj. Etleva Gjellaj, shefe e Sektorit të Statistikave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Z.Gianni Rosas dhe Znj. Valli Corbanese të ILO-s ofruan asistencë teknike për hartimin e instrumentit anketues, ndërtimin e programit trajnues për ngritjen e kapaciteteve të anketuesve të SHKP-ës dhe për zhvillimin e instrumentit metodologjik për tabelimin e të dhënave. Znj.Daniela Zampini dhe Znj. Teuta Zejno asistuan në redaktimin dhe faqosjen e këtij raporti.

Dëshirojmë të shprehim vlerësimin tonë për stafin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit që mori pjesë në këtë përpjekje të përbashkët. Gjithashtu, falenderojmë Z.Kastriot Sulka, Zëvendësministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), dhe Z. Muharrem Xhelili dhe stafin e tij të Drejtorisë së Politikave të Punësimit të MPÇSSHB për mbështetjen e tyre të paçmueshme gjatë gjithë aktivitetit të sondazhit.

Mirela Kasmi,
Koordinatore Kombëtare e Projektit të ILO-s

Tabelimet kryesore të të dhënave të sondazhit

1. KARAKTERISTIKAT E NDËRMARRJEVE

1.1	Ndërmarrjet sipas rajoneve.....	1
1.2	Ndërmarrjet sipas sektorit ekonomik.....	3
1.3	Ndërmarrjet sipas llojit.....	5
1.4	Ndërmarrjet sipas madhësisë.....	8
1.5	Ndërmarrjet sipas kohës së operimit.....	9

2. KARAKTERISTIKAT E FORCËS SË PUNËS

2.1	Forca e punës sipas sektorit ekonomik.....	11
2.2	Forca e punës sipas kategorisë profesionale.....	13
2.3	Forca e punës sipas moshës.....	16
2.4	Forca e punës sipas gjinisë.....	18
2.5	Forca e punës sipas nivelit arsimor.....	19

3. TENDENCAT E PUNËSIMIT.....22

4. TENDENCAT NË PUNËSIMIN E FORCËS SË PUNËS

4.1	Mënyrat e marrjes në punë.....	30
4.2	Preferencat e punësimit (sipas moshës, gjinisë, arsimit).....	31
4.3	Aftësitë më të kërkuara.....	32
4.4	Karakteristikat e vendeve të lira të punës.....	37

5. VLERËSIMI I AFTËSIVE TË FORCËS SË PUNËS

5.1	Shkalla e kompetencës së forcës së punës.....	41
5.2	Mungesa e zotësisë	42
5.3	Mangësitë në aftësi.....	43
5.4	Pengesat për të zhvilluar kompetencat.....	46
5.5	Strategjitë për të kapërcyer kufizimet në aftësitë bazë të forcës së punës.....	48
5.6	Arsyet e ndryshimit të aftësive.....	49
5.7	Parashikimet afatshkurtra të aftësive.....	51

6. ARSIMI DHE TRAJNIMI I PUNONJËSVE

6.1	Ndërmarrjet që ofrojnë trajnim (sipas sektorit ekonomik).....	56
6.2	Ofruesit e trajnimit.....	57
6.3	Kohëzgjatja e trajnimit.....	57
6.4	Karakteristikat e punonjësve që janë trajnuar.....	58
6.5	Financimi i zhvillimit të aftësive.....	59
6.6	Përvoja në programet e praktikave profesionale	60

7. KUSHTET E PUNËS

7.1	Kontratat e punësimit.....	61
7.2	Përfitimet që i jepen punonjësve.....	62

Aneksi 1

Metodologjia e sondazhit

Lista e figurave

Figura 1.1	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas rajoneve
Figura 1.2	Ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomikë
Figura 1.3.1	Bizneset familjare sipas sektorëve ekonomikë
Figura 1.3.2	Kompanitë private sipas sektorëve ekonomikë
Figura 1.3.3	Ndërmarrjet/kompanitë me kapital të huaj sipas sektorëve ekonomikë
Figura 2.1.1	Përqindja e forcës së punës krahasuar me përqindjen e ndërmarrjeve
Figura 2.1.2	Shpërndarja e forcës së punës sipas ndërmarrjeve dhe sipas rajoneve
Figura 2.4	Forca e punës sipas gjinisë
Figura 3	Përqindjet e vendeve të lira sipas rajoneve
Figura 4.2	Preferencat e rekrutimit sipas moshës, gjinisë dhe arsimit
Figura 4.3.1	Aftësitë më të kërkuara sipas kategorive profesionale
Figura 4.3.2	Aftësitë më të kërkuara sipas kategorive profesionale dhe rajoneve
Figura 4.4.1	Vendet e lira të vështira për t'u plotësuar sipas sektorëve ekonomikë
Figura 4.4.2	Vendet e lira të vështira për t'u plotësuar sipas rajoneve
Figura 4.4.3	Vendet e lira të vështira për t'u plotësuar sipas profesioneve
Figura 4.4.4	Arsyet sipas punëdhënësve pse vendet e lira janë të vështira për t'u plotësuar
Figura 4.4.5	Aftësitë e vështira për t'u gjetur tek aplikantët
Figura 4.4.6	Planet e kompanive për të zgjidhur problemin e vendeve të lira “të vështira për t'u plotësuar”
Figura 5.2	Shpeshtësia e arsyeve kryesore të mungesës së zotësisë
Figura 5.3	Përqindjet e ndërmarrjeve me mangësi në aftësi sipas sektorëve ekonomikë
Figura 5.4	Pengesat kryesore për zhvillimin e kompetencave tek forca e punës
Figura 5.6	Përqindjet e arsyeve të ndryshimit të aftësive
Figura 6.1	Përqindjet e ndërmarrjeve që kanë ofruar trajnim sipas sektorëve ekonomikë
Figura 6.2	Ofruesit e trajnimeve
Figura 6.4.1	Përqindjet e trajnimeve sipas sektorëve ekonomikë dhe kategorive profesionale
Figura 6.4.2	Përqindjet e grupeve të trajnuara sipas karakteristikave kryesore
Figura 6.5	Përqindjet e kostove të trajnimit të mbuluara nga institucionet/individët
Figura 7.1.1	Përqindjet e ndërmarrjeve me dhe pa kontrata punësimi, sipas sektorëve ekonomikë
Figura 7.1.2	Përqindjet e ndërmarrjeve me dhe pa kontrata punësimi sipas rajoneve
Figura 7.2	Përqindja e zbatimit të përfitimit sipas ndërmarrjeve

Lista e tabelave

Tabela 1.1	Shpërndarja e ndërmarrjeve brenda rajoneve
Tabela 1.2.1	Ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 1.2.2	Përqindjet e sektorëve kryesorë ekonomikë
Tabela 1.3.1	Ndërmarrjet sipas llojit të pronësisë
Tabela 1.3.2	Kompanitë private dhe bizneset familjare sipas rajoneve
Tabela 1.4.1	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë
Tabela 1.4.2	Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe rajoneve
Tabela 1.5	Ndërmarrjet sipas kohës së operimit
Tabela 2.1.1	Punonjësit sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 2.1.2	Përqindjet e forcës së punës sipas rajoneve
Tabela 2.2.1	Përqindjet e forcës së punës sipas kategorive profesionale dhe sektorëve ekonomikë
Tabela 2.2.2	Përqindjet e forcës së punës sipas kategorive profesionale dhe rajoneve
Tabela 2.2.3	Forca e punës sipas karakteristikave kryesore dhe kategorive profesionale
Tabela 2.3.1	Përqindjet e forcës së punës sipas moshës
Tabela 2.3.2	Numri i përgjithshëm i punonjësve sipas moshës dhe kategorisë profesionale
Tabela 2.3.3	Përqindja e forcës së punës sipas grupmoshës dhe sipas rajoneve
Tabela 2.4.1	Forca e punës sipas gjinisë dhe kategorive profesionale
Tabela 2.4.2	Përqindjet e forcës së punës sipas gjinisë dhe sipas rajoneve
Tabela 2.5.1	Përqindjet e forcës së punës sipas nivelit arsimor
Tabela 2.5.2	Përqindja e forcës së punës sipas nivelit arsimor dhe kategorisë profesionale
Tabela 2.5.3	Përqindjet e forcës së punës sipas nivelit arsimor brenda rajoneve
Tabela 3.1	Ndërmarrjet me rritje punësimi
Tabela 3.2	Ndërmarrjet në rritje sipas llojeve të pronësisë
Tabela 3.3	Përqindja e ndërmarrjeve në rritje sipas llojit të pronësisë
Tabela 3.4	Ndërmarrjet në rritje sipas rajoneve
Tabela 3.5	Vendet e parashikuara të lira sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 3.6	Përqindjet e dhjetë profesioneve më të kërkuara sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 3.7	Dhjetë profesionet më të kërkuara sipas rajoneve
Tabela 3.8	Aftësitë bazë të punësueshmërisë dhe aftësitë profesionale për dhjetë profesionet më të kërkuara
Tabela 4.1.1	Praktikat e marrjes në punë sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 4.1.2	Praktikat e marrjes në punë sipas rajoneve
Tabela 4.3.1	Aftësitë më të kërkuara sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 4.4.1	Përqindjet e vendeve të lira sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 4.4.2	Përqindjet e vendeve të lira sipas rajoneve

Tabela 5.1	Stafi i konsideruar plotësisht i aftë sipas sektorëve ekonomikë dhe kategorive profesionale
Tabela 5.2.1	Shkaqet e mungesës së zotësisë sipas kategorive profesionale
Tabela 5.2.2	Shkaqet e mungesës së zotësisë sipas rajoneve
Tabela 5.3.1	Përqindjet e ndërmarrjeve që nuk kanë një apo disa aftësi të listës së referencës (sipas sektorëve ekonomikë)
Tabela 5.3.2	Përqindjet e mangësive në aftësi sipas kategorive profesionale
Tabela 5.4.1	Përqindjet e pengesave për zhvillimin e forcës së punës sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 5.4.2	Përqindjet e pengesave sipas kategorive profesionale
Tabela 5.5.1	Veprime të ndërmarra lidhur me mungesat në aftësi
Tabela 5.5.2	Përqindjet e veprimeve të ndërmarra për të kapërcyer mungesat në aftësi sipas rajoneve
Tabela 5.6.1	Përqindjet e ndryshimeve të pritshme të nevojave për aftësi sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 5.6.2	Ndryshimi i nevojave për aftësi kundrejt perspektivave të rritjes së punësimit
Tabela 5.6.3	Përqindjet e ndryshimeve të pritshme të aftësive sipas rajoneve
Tabela 5.7.1	Përqindjet e vlerësimeve për aftësitë e punësueshmërisë për menaxherët, stafin profesional dhe administrativ
Tabela 5.7.2	Përqindjet e vlerësimeve për aftësitë e punësueshmërisë për punonjësit në prodhim dhe punë elementare
Tabela 5.7.3	Vlerësimi mesatar i aftësive të punësueshmërisë
Tabela 5.7.4	Vlerësimi mesatar i aftësive të punësueshmërisë sipas rritjes së punësimit
Tabela 5.7.5	Vlerësimi mesatar i aftësive të punësueshmërisë sipas rajoneve
Tabela 6.1	Përqindjet e ndërmarrjeve të intervistuar sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 6.3.1	Kohëzgjatja e trajnimit sipas ofruesit të trajnimit
Tabela 6.3.2	Përqindjet e ndërmarrjeve që kanë ofruar trajnim sipas rajoneve
Tabela 7.1	Përqindjet e ndërmarrjeve sipas llojit dhe kohëzgjatjes së kontratave dhe sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 7.2.1	Përqindja e përfitimit të dhënë, sipas sektorëve ekonomikë
Tabela 7.2.2	Përqindja e përfitimit të dhënë, sipas rajoneve
Tabela A.1.	Informacion nga rregjistrat e biznesit
Tabela A.2.	Kampioni
Tabela A.3.	Përfaqësueshmëria e kampionit sipas rajonit
Tabela A.4.	Shembull i kuadrit të kampionit


1. KARAKTERISTIKAT E NDËRMARRJEVE

Për sondazhin e nevojave për aftësi u vizituan/intervistuan 964 ndërmarrje. Informacioni bazë i mbledhur mbi këto ndërmarrje lidhet me sektorin ekonomik, llojin, madhësinë dhe kohën e operimit të tyre.

1.1 Ndërmarrjet sipas rajoneve

Shpërndarja gjeografike e këtyre ndërmarrjeve sipas rajoneve është dhënë në Figurën 1.1

Figura 1.1: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas rajoneve



Analiza e mëtejshme e shpërndarjes brenda rajonit (në nivel vendor) zbulon se 85% e ndërmarrjeve të intervistuar janë të lokalizuara në rrethet kryesore të rajoneve (shih Tabelën 1.1).

Tabela 1.1: Shpërndarja e ndërmarrjeve brenda rajoneve

Rajoni	Totali	Niveli vendor	
		numri	në %
BERAT	50	15	30
DIBER	30	15	50
DURRES	100	0	0
ELBASAN	50	15	30
FIER	72	15	21
GJIROKASTER	30	10	33
KORÇE	70	20	29
KUKES	25	5	20
LEZHE	50	10	20
SHKODER	70	10	15
TIRANE	349	10	3.5
VLORE	68	15	22
Total	964	140	15

Baza e të dhënave tregon që rrethet Lushnjë, Pogradec, Kuçovë, Kavajë dhe Sarandë e kanë zhvilluar sondazhin në 10 ndërmarrje secila, ndërsa rretheve të tjera iu janë caktuar vetëm nga 5 ndërmarrje.

Rajoni i Durrësit nuk e ka zhvilluar sondazhin në nivel vendor, ndërsa rajoni i Kukësit i ka humbur të dhënat e marra në rrethin e Hasit.

1.2 Ndërmarrjet sipas sektorit ekonomik

Tabela 1.2.1 paraqet shpërndarjen e ndërmarrjeve sipas sektorit ekonomik.

Tabela 1.2.1: Ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomikë

Sektori ekonomik	Ndërmarrje		Të punësuar	
	numri	%	numri	%
A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	11	1.1	210	1.1
B. Minierë dhe gurorë	10	1	230	1.2
C. Industri përpunuese	205	21.3	8690	45.3
D. Furnizimi me elektricitet, gaz dhe ujë	18	1.9	479	2.5
F. Ndërtim	176	18.3	3760	19.6
G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	306	31.7	2911	15.2
H. Transport, magazinim dhe komunikacion	34	3.5	541	2.8
I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve	142	14.7	1497	7.8
P. Arsim	13	1.3	198	1
Q. Shëndetsi	18	1.9	177	0.9
Të tjera	31	3.1	480	2.5
Total	964	100.0	19173	100.0

Ndërmarrjet e përzgjedhura përfaqësojnë të gjitha degët e sektorëve ekonomikë në Shqipëri. Sektorët më të përfaqësuar janë “Industri përpunuese”, “Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime”, “Ndërtim” dhe “Aktivitetet e shërbimeve” (shih Figurën 1.2). Ky konstatim është i vërtetë dhe për numrin e të punësuarve në këto ndërmarrje.

Figura 1.2: Ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomikë




Tabela 1.2.2 paraqet masën e sektorëve ekonomikë më të përfaqësuar në totalin e ndërmarrjeve të intervistuar sipas rajoneve.

Tabela 1.2.2: Përqindjet e sektorëve kryesorë ekonomikë

Rajoni	Numri i ndërmarrjeve	Tregti dhe riparime në % të totalit	Industria përpunuese në % të totalit	Ndërtimi në % të totalit	Aktivitetet e shërbimeve në % të totalit
BERAT	50	2	20	18	46
DIBER	30	33	30	23	0
DURRES	100	33	18	0	24
ELBASAN	50	18	0	22	18
FIER	72	46	28	25	0
GJIROKASTER	30	7	47	27	20
KORÇE	70	34	37	27	0
KUKES	25	40	4	48	0
LEZHE	50	40	22	22	12
SHKODER	70	37	26	14	20
TIRANE	349	36	19	16	16
VLORE	68	21	18	21	7
Total	964	100.0	100.0	100.0	100.0

1.3 Ndërmarrjet sipas llojit


Lidhur me llojin e pronësisë, ndërmarrjet janë klasifikuar në 5 kategori (shih Tabelën 1.3.1).

Tabela 1.3.1: Ndërmarrjet sipas llojit të pronësisë

Lloji i pronësisë së ndërmarrjeve	Numri	% e totalit
Biznes familjar	192	20
Ndërmarrje me kapital të huaj	20	2
Kompani private	693	72
Ndërmarrje me kapital të përbashkët	27	3
Të tjera	32	3
Total	964	100.0

Raporti i bizneseve familjare (20% e totalit) sipas sektorëve ekonomikë jepet në Figurën 1.3.1.


Figura 1.3.1: Biznesi familjar sipas sektorëve ekonomikë



Bizneset familjare në sektorin “Tregti dhe riparime” janë të angazhuar kryesisht në distribucionin e vogël dhe në mirëmbajtjen e paisjeve shtëpiake; bizneset familjare në “Aktivitete shërbimesh” janë kryesisht bare dhe restorante, ndërsa në “Industri përpunuese” bizneset familjare merren me përpunimin e produkteve ushqimore, prodhim mobiljesh dhe përpunim të duraluminit.


Kompanitë private (72% e totalit) (shih Figurën 1.3.2) në sektorin “Tregti dhe riparime” janë grosistë të mëdhenj, veçanërisht në qytetet ku ka më shumë aktivitet ekonomik; në sektorin “Industri përpunuese”, ato operojnë kryesisht në tekstile, veshje dhe lëkurë-këpucë. Industria përpunuese është kryesisht e zhvilluar në rajonet Berat, Durrës, Fier, Korçë, Shkodër dhe Tiranë. Rajoni i Elbasanit është i njohur për prodhimin e produkteve prej metali, ndërsa rajoni i Lezhës për përpunimin e peshkut. Kompanitë në sektorin e ndërtimit përgjithësisht kanë numër të madh të punësuarish.

Figura 1.3.2: Kompanitë private sipas sektorëve ekonomikë



Filialet e kompanive me kapital të huaj (2% e totalit) janë të përqëndruara në rajonin e Tiranës (50%). Figura 1.3.3 paraqet shpërndarjen e ndërmarrjeve me kapital të huaj sipas sektorëve të ekonomisë.

Figura 1.3.3: Kompanitë me kapital të huaj sipas sektorëve ekonomikë



Të dhënat e sondazhit tregojnë se 44% e ndërmarrjeve me kapital të përbashkët (3% e totalit) i përkasin sektorit “tregti dhe riparime”, ndërsa 30% e tyre janë në industrinë përpunuese. Në Tiranë ndodhen 52% e këtyre ndërmarrjeve.

Shumica e ndërmarrjeve të intervistuar ishin kompani private dhe biznese familjare. Tabela 1.3.2 tregon se si këto dy lloje të ndërmarrjeve janë të shpërndara nëpër rajone.

Tabela 1.3.2: Kompanitë private dhe bizneset familjare sipas rajoneve

Rajoni	Totali	Kompani private		Biznese familjare	
		numri	% e totalit	numri	% e totalit
BERAT	50	24	48	25	50
DIBER	30	24	80	2	7
DURRES	100	55	55	43	43
ELBASAN	50	38	76	5	10
FIER	72	46	64	21	29
GJIROKASTER	30	24	80	2	7
KORÇE	70	66	94	0	0
KUKES	25	25	100	0	0
LEZHE	50	34	68	15	30
SHKODER	70	24	34	31	44
TIRANE	349	270	77	46	13
VLORE	68	63	93	2	3
Totali	964	693	72	192	20

Në nivel rajonal, kompanitë private zënë 34% deri në 100% të sektorit të biznesit , ndërsa bizneset familjare, që zakonisht operojnë në aktivitetet e shërbimeve, janë pak të përfaqësuar në rajonet me aktivitet më të paktë shërbimesh (Kukës, Korçë, Dibër, Gjirokastrë dhe Vlorë).

1.4 Ndërmarrjet sipas madhësisë

Përsa i përket madhësisë, 78% e ndërmarrjeve të vrojtuar kanë 1 deri 20 punonjës. Kjo ishte e pritshme meqenëse 50% e tyre operojnë në sektorët “tregti dhe riparime” dhe “shërbime” ku zakonisht ndërmarrjet janë të vogla përsa i përket numrit të të punësuarve (shih Tabelën 1.4.1).

Tabela 1.4.1: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë

Madhësia e ndërmarrjeve	Numri i ndërmarrjeve	% e totalit
1 – 5 punonjës	349	36
6 – 20 punonjës	407	42
21 – 50 punonjës	138	14
51 – 150 punonjës	55	6
151 – 200 punonjës	7	1
Mbi 200 punonjës	8	1
Totali	964	100.0

Përsa i përket lidhjes midis madhësisë së ndërmarrjeve dhe degës së aktivitetit të tyre ekonomik, sondazhi tregon se:

- Ndërmarrjet me 1 – 5 punonjës janë kryesisht në sektorin “tregti dhe riparime” (44% e tyre);
- Ndërmarrjet me 6-20 punonjës janë kryesisht në:
 - tregti dhe riparime (30%)
 - industri përpunuese (21%)
- Ndërmarrjet me 21-50 punonjës janë kryesisht në:
 - ndërtim (34%)
 - industri përpunuese (25%)
 - tregti dhe riparime (18%)
- Ndërmarrjet me 51-150 punonjës janë kryesisht në:
 - industri përpunuese (44%)
 - ndërtim (25%)
- Ndërmarrjet me më shumë se 150 punonjës janë kryesisht në industrinë përpunuese (87%).

Tabela 1.4.2: Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe rajoneve

Rajoni	Madhësia e ndërmarrjeve në % të totalit						
	totali	1-5 punonjës	6-20 punonjës	21- 50 punonjës	51-150 punonjës	151-200 punonjës	mbi 200 punonjës
BERAT	50	56	40	4	0	0	0
DIBER	30	37	27	30	7	0	0
DURRES	100	70	24	4	2	0	0
ELBASAN	50	16	54	22	6	2	0
FIER	72	39	33	21	3	1	3
GJIROKASTER	30	20	57	23	0	0	0
KORÇE	70	26	57	17	0	0	0
KUKES	25	36	60	4	0	0	0
LEZHE	50	52	18	18	6	2	4
SHKODER	70	44	37	10	6	1	1
TIRANE	349	31	44	15	9	1	1
VLORE	68	10	63	13	12	0	1
Totali	964	36	42	14	6	1	1

Vihen re ndryshime midis rajoneve. Në rajonet Berat, Durrës e Kukës, shumica e ndërmarrjeve kanë 1-20 punonjës. Në Elbasan (industria e përpunimit të metaleve), Dibër (miniera dhe gurorë), Gjirokastrë (përpunimi i pijeve), Lezhë (përpunimi i peshkut), Fier dhe Korçë (prodhimi i veshjeve) dhe Shkodër (prodhimi i lëkurë-këpucëve) ka ndërmarrje më të mëdha (20-150 punonjës). Ndërmarrjet me më shumë se 150 punonjës janë kryesisht në industrinë përpunuese dhe ndërtim.

1.5 Ndërmarrjet sipas kohës së operimit

Koha e operimit në biznes të një ndërmarrje është një variabël i rëndësishëm kur vlerësojmë potencialin e krijimit të vendeve të punës të ndërmarrjes.

Në këtë kuptim, pjesa më e madhe (59%) e ndërmarrjeve të intervistuar operonin në biznes prej më shumë se 5 vjetësh (shih Tabelën 1.5).

Tabela 1.5: Ndërmarrjet sipas kohës së operimit

Koha në biznes	Numri i ndërmarrjeve	Në % të totalit
Deri në 12 muaj	18	2
1 – 2 vjet	113	12
2 – 5 vjet	262	27
Më shumë se 5 vjet	571	59
Totali	964	100.0

Po ashtu, sondazhi tregon se:

- Ndërmarrjet e reja (deri në 12 muaj) janë kryesisht (75%) në sektorin “tregti dhe riparime”
- Ndërmarrjet me 1 – 2 vjet kohë operimi në biznes janë si më poshtë:
 - 36% në sektorin e tregtisë dhe riparimeve
 - 17% në industrinë përpunuese
 - 12% në ndërtim
 - 12% në aktivitetet e shërbimeve
- Ndërmarrjet me 2 - 5 vjet kohë operimi në biznes janë si më poshtë:
 - 34% në sektorin e tregtisë dhe riparimeve
 - 16% në industrinë përpunuese
 - 16% në ndërtim
 - 11% në aktivitetet e shërbimeve
- Ndërmarrjet me mbi 5 vjet kohë operimi në biznes janë si më poshtë:
 - 29% në sektorin e tregtisë dhe riparimeve
 - 24% në industrinë përpunuese
 - 20% në ndërtim
 - 10% në aktivitetet e shërbimeve.

2. KARAKTERISTIKAT E FORCËS SË PUNËS

Ndërmarrjet e intervistuarra përfshinin në total 19173 punonjës. Sondazhi konsideroi karakteristikat e mëposhtme:

- kategoritë profesionale
- moshën
- gjininë
- nivelin arsimor

Të gjitha karakteristikat e mësipërme janë përpunuar sipas sektorëve ekonomikë dhe sipas rajoneve.

2.1 Forca e punës sipas sektorit ekonomik


Shpërndarja e punonjësve sipas aktiviteteve ekonomike është dhënë në tabelën 2.1.1.

Tabela 2.1.1: Punonjësit sipas sektorëve ekonomikë

Sektori ekonomik	Punonjësit	
	Numri	%
A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	210	1.1
B. Minierë dhe gurorë	230	1.2
C. Industri përpunuese	8690	45.3
D. Furnizimi me elektricitet, gaz dhe ujë	479	2.5
F. Ndërtim	3760	19.6
G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	2911	15.2
H. Transport, magazinim dhe komunikacion	541	2.8
I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve	1497	7.8
P. Arsim	198	1.0
Q. Shëndetsi	177	0.9
Të tjera	480	2.5
Total	19173	100.0

Figura 2.1.1 krahason përqindjen e ndërmarrjeve me përqindjen e të punësuarve në disa prej sektorëve ekonomikë kryesorë në nivel kombëtar. Industria përpunuese ka numrin më të madh të të punësuarve me një mesatare prej 42 të punësuarish për ndërmarrje.

Figura 2.1.1: Përqindja e forcës së punës krahasuar me përqindjen e ndërmarrjeve



Legjenda: I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve
 G. Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime
 F. Ndërtim
 C. Industri përpunuese


Tabela e mëposhtme ofron një pamje të shpërndarjes së forcës së punës sipas rajoneve, si një përqindje e totalit.

Tabela 2.1.2: Përqindjet e shpërndarjes së forcës së punës sipas rajoneve

Rajoni	Numri i punonjësve	Forca e punës në %
BERAT	397	2
DIBER	514	3
DURRES	731	4
ELBASAN	989	5
FIER	1545	8
GJIROKASTER	877	5
KORÇE	1331	7
KUKES	221	1
LEZHE	1523	8
SHKODER	1903	10
TIRANE	7181	37
VLORE	1961	10
Totali	19173	100

Figura 2.1.2 krahason rajonet përsa i përket përqindjeve të forcës së punës dhe të ndërmarrjeve.

Figura 2.1.2: Shpërndarja e forcës së punës sipas ndërmarrjeve dhe sipas rajoneve



2.2 Forca e punës sipas kategorisë profesionale

Tabela 2.2.1 paraqet shpërndarjen e forcës së punës sipas kategorisë profesionale dhe sektorit ekonomik.

Tabela 2.2.1: Përqindjet e forcës së punës sipas kategorive profesionale dhe sektorëve ekonomikë

Sektori Ekonomik	Totali	Menaxherë	Specialistë e teknikë të fushës	Punonjës në administratë dhe sekretari	Zanatçinj të kualifikuar	Punonjës në shitje e shërbim klienti	Punëtorë industrialë	Punëtorë për punë elementare
A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	210	9	28	5	21	3	10	24
B. Minierë dhe gurorë	230	5	12	6	20	4	8	44
C. Industri përpunuese	8690	4	5	4	15	4	44	25
D. Furnizimi me elektricitet, gaz dhe ujë	479	5	14	5	14	4	44	14
F. Ndërtim	3760	8	10	5	24	2	8	43
G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	2911	15	9	9	9	34	7	16
H. Transport, magazinim dhe komunikacion	541	10	18	14	10	33	9	7
I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve	1497	10	15	6	10	27	2	30
P. Arsim	198	8	70	5	1	5	0	12
Q. Shëndetsi	177	15	32	7	34	10	0	2
Të tjera	480	9	15	11	9	9	2	44
Totali	19173	7	9	6	15	11	24	27

Tabela 2.2.2: Përqindjet e forcës së punës sipas kategorive profesionale dhe rajoneve

Rajoni	Totali	Menaxherë	Specialistë e teknikë të fushës	Punonjës në administratë dhe sekretari	Zanatçinj të kualifikuar	Punonjës në shitje e shërbim klienti	Punëtorë industrialë	Punëtorë për punë elementare
BERAT	397	12	4	6	10	12	11	45
DIBER	514	9	23	8	11	21	0	27
DURRES	731	15	17	4	20	16	17	11
ELBASAN	989	9	16	7	14	10	25	19
FIER	1545	6	10	8	8	5	41	22
GJIROKASTER	877	6	4	4	5	6	62	13
KORÇE	1331	8	5	4	19	6	34	24
KUKES	221	14	8	10	11	9	13	36
LEZHE	1523	4	3	3	15	4	58	13
SHKODER	1903	5	5	3	34	7	10	37
TIRANE	7181	9	12	7	12	17	20	24
VLORE	1961	5	7	4	19	6	4	55
Total	19173	7	9	6	15	11	24	27

Tabela 2.2.3: Forca e punës sipas karakteristikave kryesore dhe kategorive profesionale

Karakteristikat e punonjësve	Menaxherë		Specialistë e teknikë të fushës		Punonjës në administratë dhe sekretari		Zanatçinj të kualifikuar		Punonjës në shitje e shërbim klienti		Punëtorë industrialë		Punëtorë për punë elementare	
Mosha	25-55	89	25-55	88	25-55	89	25-39	51	25-39	55	25-39	50	25-55	82
Gjinia	mashkull	75	mashkull	68	femër	61	mashkull	62	mashkull	59	femër	72	mashkull	56
Arsimimi	universitet	66	I mesëm	41	universitet	61	9-vjeçar	42	I mesëm	71	9-vjeçar	44	9-vjeçar	57
			universitet	41			I mesëm	58			I mesëm	50		

2.3 Forca e punës sipas moshës

Në lidhje me moshën, numri më i madh i të punësuarve është më pak se 40 vjeç (shih Tabelën 2.3.1).

Tabela 2.3.1: Përqindjet e forcës së punës sipas moshës

Totali	15 – 24 vjeç	25 – 39 vjeç	40 – 55 vjeç	mbi 55 vjeç
19173	10	46	37	6

Tabela 2.3.2: Numri i përgjithshëm i punonjësve sipas moshës dhe kategorisë profesionale

Mosha	Total	Menaxherë	Specialistë e teknikë të fushës	Punonjës në administratë dhe sekretari	Zanatçinj të kualifikuar	Punonjës në shitje e shërbim klienti	Punëtorë industrialë	Punëtorë për punë elementare
15-24	1992	1	3	3	16	8	36	33
25-39	8912	6	8	6	17	13	26	24
40-55	7140	10	12	6	13	10	20	29
55+	1129	13	13	6	16	9	16	26
Total	19173	7	9	6	15	11	24	27

- Grupmosha deri 24 vjeç janë kryesisht punëtorë industrialë apo punonjës për punë elementare. Këto kategori kërkojnë më pak përvojë pune dhe më shumë aftësi fizike.
- I njëjti konkluzion është pothuajse i vërtetë edhe për grupmoshën 25-39 vjeç. Dallimi me grupin e sipërm qëndron tek fakti që përqindjet e punonjësve të grupmoshës 25-39 vjeç janë më të larta në kategoritë që kërkojnë më shumë kualifikime.
- Grupmosha 40-50 vjeç shihet më së shumti në kategoritë e menaxherëve dhe stafit profesional dhe administrativ. Përqindjet vijnë duke u ulur në kategoritë e tjera profesionale. Zakonisht, kur kjo grupmoshë është e punësuar në kategorinë “punonjës në shitje dhe shërbim klienti”, ndodh pasi sipërmarrja është biznes familjar.
- Situata për grupmoshën mbi 55 vjeç është pothuajse e njëjtë si për grupmoshën 40-50 vjeç.


Tabela 2.3.3: Përqindja e forcës së punës sipas grupmoshës dhe sipas rajoneve

Rajoni	Totali	15 – 24 vjeç	25 – 39 vjeç	40 – 55 vjeç	Mbi 55 vjeç
BERAT	397	7	44	43	7
DIBER	514	2	30	61	7
DURRES	731	7	58	32	4
ELBASAN	989	3	39	50	8
FIER	1545	10	36	48	7
GJIROKASTER	877	7	50	38	5
KORÇE	1331	4	40	49	6
KUKES	221	5	47	46	2
LEZHE	1523	24	44	28	4
SHKODER	1903	19	47	30	4
TIRANE	7181	9	51	34	6
VLORE	1961	11	48	35	7
Total	19173	10	46	37	6

Numri i të rinjve (deri 25 vjeç) është më i lartë në rajonet ku është më e zhvilluar industria përpunuese. Shpërndarja e njerëzve me moshë midis 25 - 55 vjeç është pothuaj e njëjtë në të gjitha rajonet. Grupmosha mbi 55 vjeç është e paktë në të gjitha rajonet.

2.4 Forca e punës sipas gjinisë

Figura 2.4: Forca e punës sipas gjinisë



Të dhënat tregojnë se 52% e punonjësve janë meshkuj.

Tablela 2.4.1: Forca e punës sipas gjinisë dhe kategorive profesionale

Gjinia	Total	Menaxherë	Specialistë e teknikë të fushës	Punonjës në administratë dhe sekretari	Zanatçinj të kualifikuar	Punonjës në shitje e shërbim klienti	Punëtorë industrialë	Punëtorë për punë elementare
Femra	9215	4	6	7	12	9	36	25
Meshkuj	9958	11	12	4	18	13	13	29
Total	19173	7	9	6	15	11	24	27

Përqindja më e lartë e femrave është në kategoritë e punonjësve industrialë dhe në punë elementare. Kjo mund t'i detyrohet faktit se 45% e ndërmarrjeve të intervistuara i përkasin industrisë përpunuese ku 80% e të punësuarve janë femra. Përqindja e punonjësve meshkuj është pak a shumë e njëjtë në të gjitha kategoritë profesionale, përjashtuar administratën (ku femrat dominojnë) dhe punët elementare (ku meshkujt dominojnë për shkak të kërkesave për aftësi fizike).

Tabela 2.4.2: Përqindjet e forcës së punës sipas gjinisë dhe sipas rajoneve

Rajonet	Totali	Femra	Meshkuj
BERAT	397	32	68
DIBER	514	21	79
DURRES	731	59	41
ELBASAN	989	27	73
FIER	1545	34	66
GJIROKASTER	877	66	34
KORÇE	1331	57	43
KUKES	221	23	77
LEZHE	1523	73	27
SHKODER	1903	67	33
TIRANE	7181	44	56
VLORE	1961	42	58
Total	19173	48	52

Tabela 2.4.2 tregon se ka rajone ku dominojnë punonjësit meshkuj, si në Dibër (minierat dhe guroret), Elbasan (përpunimi dhe fabrikimi i metaleve) dhe Kukës (ndërtimi), dhe rajone të tjera ku dominojnë punonjëset femra, si në Gjirokastrë (prodhimi i pijeve), Lezhë (përpunimi i peshkut) dhe Shkodër (përpunimi i lëkurë - këpucëve).

2.5 Forca e punës sipas nivelit arsimor

Në bazë të nivelit të arsimit, forca e punës mund të ndahet në 7 grupe të ndryshme (shih Tabelën 2.5.1). Të dhënat tregojnë që 47.4% e punonjësve kanë arsimin e lartë sekondar (shkollën e mesme të përgjithshme apo profesionale).

Tabela 2.5.1: Përqindjet e forcës së punës sipas nivelit arsimor

Totali	Më pak se fillor	Fillor	I ulët sekondar	I lartë sekondar	Universitar	Pas universitar	Të tjera
19173	0,4	2,1	33,7	47,4	15,8	0,5	0,0

Tabela 2.5.2: Përqindja e forcës së punës sipas nivelit arsimor dhe kategorisë profesionale

Niveli arsimor	Total	Menaxherë	Specialistë e teknikë të fushës	Punonjës në administratë dhe sekretari	Zanatçinjtë të kualifikuar	Punonjës në shitje e shërbim klienti	Punëtorë industrialë	Punëtorë për punë elementare
Më pak se fillor	75	0	0	0	0	5	69	25
Fillor	403	0	0	0	9	4	43	44
I ulët sekondar	6470	0	2	0	17	4	31	46
I lartë sekondar	9093	5	8	4	19	17	26	22
Universitar	3038	31	31	22	2	11	2	1
Pas universitar	88	56	15	8	1	18	2	0
Total	19173	7	9	6	15	11	24	27

Gjetjet kryesore janë si vijon:

- Punonjësit me nivel arsimor të ulët (më pak se fillor) janë kryesisht punëtorë industrialë. Më shumë se 82% e punonjësve të punësuar si punëtorë industrialë në industrinë përpunuese kanë përfunduar arsimin fillor.
- Punonjësit që kanë përfunduar arsimin fillor dhe të ulët sekondar (shkollën 8 ose 9 vjeçare) janë kryesisht të punësuar si punonjës industrialë apo në punë elementare. Shumica e tyre punon në industrinë përpunuese dhe në ndërtim: 41% e punonjësve në industrinë përpunuese dhe 31% e punonjësve në ndërtim i përkasin këtyre kategorive.
- Shumica e punonjësve në profesione prodhimi dhe punësh elementare (zanatçinjtë e kualifikuar, punonjësit në shërbim me klientin, punonjësit industrialë apo për punë elementare) janë me arsim të lartë sekondar (shkollë të mesme).
- Shumica e menaxherëve, stafit profesional dhe në administratë kanë arsimin universitar dhe pas universitar.

Tabela 2.5.3: Përqindjet e forcës së punës sipas nivelit arsimor brenda rajoneve

Rajoni	total	Më pak se fillor	Fillor	I ulët sekondar	I lartë sekondar	Universitar	Pas universitar	Të tjera
BERAT	397	0,0	4,8	30,2	53,9	9,8	0	1
DIBER	514	0,0	0,0	23,5	60,1	16,0	0	0
DURRES	731	0,0	1,8	30,4	45,7	20,2	2	0
ELBASAN	989	0,2	0,5	21,2	54,9	22,5	1	0
FIER	1545	0,8	4,1	25,7	54,0	15,4	0	0
GJIROKASTER	877	1,7	2,4	18,7	68,3	8,9	0	0
KORÇE	1331	0,1	1,1	30,5	59,6	8,8	0	0
KUKES	221	0,0	0,0	26,2	60,2	13,6	0	0
LEZHE	1523	2,0	5,6	54,2	33,4	4,5	0	0
SHKODER	1903	0,0	1,3	56,3	34,5	7,7	0	0
TIRANE	7181	0,2	1,1	27,1	47,3	23,5	1	0
VLORE	1961	0,0	4,1	47,3	39,4	9,3	0	0
Total	19173	0,4	2,1	33,7	47,4	15,8	0	0

Përsa i përket pamjes në planin rajonal (shih Tabelën 2.5.3):

- Shumica e të punësuarve në rajonet Lezhë, Shkodër dhe Vlorë janë me nivel arsimi të ulët sekondar.
- Shumica e të punësuarve në rajonet e tjera janë me nivel arsimi të lartë sekondar.
- Numri më i madh i punonjësve me arsim universitar dhe pasuniversitar janë në rajonet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit.
- Punonjësit me nivel pasuniversitar punojnë si menaxherë në ndërmarrjet me kapital të huaj të sektorëve të industrisë përpunuese (Tiranë dhe Durrës) dhe si menaxherë dhe staf profesional në uzinat e përpunimit të metaleve (Elbasan).

3. TENDENCAT E PUNËSIMIT

Tendencat e punësimit në ndërmarrjet e intervistuara janë vëzhguar nga tre këndvështrime: i) nëse punësimi ka pësuar rritje; ii) nëse punësimi ka pësuar rënie; iii) nëse situata ka mbetur e pandryshuar.

Sondazhi vlerësoi situatën gjatë vitit paraardhës dhe vitit në vazhdim si dhe cilat ishin parashikimet e mundshme.

Tabela 3.1 paraqet ndërmarrjet që kishin një rritje pozitive vitin paraardhës dhe pritnin të rekrutnin punonjës të rinj në 12 muajt e ardhshëm. Vlerat e tabelës tregojnë numrin dhe përqindjet e ndërmarrjeve me rritje punësimi për çdo sektor ekonomik. Shihet se 30% e ndërmarrjeve të intervistuara kanë pasur një rritje në punësim dhe 30% prej tyre parashikojnë të rekrutojnë punonjës të rinj në 12 muajt e ardhshëm. Ndërmarrjet që kanë gjasa të rrisin punësimin operojnë në:

- Furnizimin me elektricitet, gaz dhe ujë;
- Ndërtim;
- Shërbime.

Tabela 3.1: Ndërmarrjet me rritje punësimi

Sektori ekonomik	total	Viti paraardhës			Parashikimi	
		Nd. në rritje		% e rritjes	Numri	%
		Numri	%			
A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	11	3	27	9	3	27
B. Minierë dhe gurorë	10	3	27	12	4	40
C. Industri përpunuese	205	77	38	26	75	37
D. Furnizimi me elektricitet, gaz dhe ujë	18	7	39	26	14	78
F. Ndërtim	176	62	35	27	68	39
G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	306	79	26	22	65	21
H. Transport, magazinim dhe komunikacion	34	7	20	30	5	15
I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve	142	28	20	17	35	25
P. Arsim	13	2	15	23	2	15
Q. Shëndetsi	18	7	39	28	6	33
Të tjera	31	13	42	5	14	45
Totali	964	288	30	25	291	30

Përsa i përket masës së rritjes, niveli i rritjes së punësimit në vitin aktual në shumicën e sektorëve të ekonomisë është 25%.

Tabela 3.2 tregon ndërmarrjet që presin të rekrutojnë punonjës të rinj në 12 muajt e ardhshëm sipas llojit të pronësisë.

Tabela 3.2: Ndërmarrjet në rritje sipas llojeve të pronësisë

Sektori ekonomik	Totali	Biznes familjar	Kompani private	Nd.me kapital të huaj	Nd. me kapital të përbashkët	Të tjera
A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	3	0	100	0	0	0
B. Minierë dhe gurore	4	25	75	0	0	0
C. Industri përpunuese	75	9	79	5	4	3
D. Furnizimi me elektricitet, gaz dhe ujë	14	7	71	7	14	0
F. Ndërtim	68	3	93	1	1	1
G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	65	14	72	2	6	6
H. Transport, magazinim dhe komunikacion	5	20	80	0	0	0
I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve	35	23	63	6	0	9
P. Arsim	2	0	100	0	0	0
Q. Shëndetsi	6	33	50	0	17	0
Të tjera	14	0	0	0	0	0
Total	291	11	78	3	4	4

Tabela 3.3. tregon përqindjen e ndërmarrjeve në rritje sipas llojit të pronësisë.

Tabela 3.3: Përqindja e ndërmarrjeve në rritje sipas llojit të pronësisë

Lloji i ndërmarrjeve	Totali i ndërmarrjeve	Ndërmarrjet në rritje	
		Numri	% sipas totalit
Biznes familjar	192	33	17
Ndërmarrje me kapital të huaj	20	227	33
Kompani private	693	9	33
Ndërmarrje me kapital të përbashkët	27	11	55
Të tjera	32	11	34
Totali	964	291	30

Tabela 3.4 paraqet ndërmarrjet që presin të rekrutojnë punonjës të rinj në 12 muajt e ardhshëm sipas rajoneve.

Tabela 3.4: Ndërmarrjet në rritje sipas rajoneve

Rajoni	Totali	Viti paraardhës			Parashikim	
		nd. me rritje		% e rritjes	numri	%
		numri	%			
BERAT	50	10	20	17	7	14
DIBER	30	11	37	24	16	53
DURRES	100	16	16	16	28	28
ELBASAN	50	12	24	19	17	34
FIER	72	20	28	19	23	32
GJIROKASTER	30	11	37	24	11	37
KORÇE	70	17	24	43	21	30
KUKES	25	8	32	52	11	44
LEZHE	50	21	42	16	20	40
SHKODER	70	18	26	15	14	20
TIRANE	349	125	36	37	99	28
VLORE	68	19	28	8	24	35
Totali	964	288	30	25	291	30

Në rajonet Berat, Shkodër dhe Tiranë, më pak ndërmarrje se në vitin paraardhës prisnin të rekrutonin punonjës të rinj në 12 muajt në vazhdim. Në rajonet e tjera, numri i ndërmarrjeve që parashikonin të rekrutonin punonjës të rinj në 12 muajt e ardhshëm ishte në rritje. Vetëm 285 ndërmarrje prisnin të rekrutonin punonjës të rinj në 12 muajt e ardhshëm. Kështu, numri i vendeve të lira që parashikohej për 12 muajt në vazhdim ishte 1650 punonjës ose 9% e forcës aktuale të punës të ndërmarrjeve të intervistuar.

Parashikimi i vendeve të lira për 12 muajt në vazhdim sipas sektorëve ekonomikë është dhënë në tabelën 3.5.


Tabela 3.5: Vendet e parashikuara të lira sipas sektorëve ekonomikë

Numri i pritshëm i punësimeve	Totali	A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	B. Minierë dhe gurorë	C. Industri përpunuese	D. Furnizim me energji, gaz dhe ujë	F. Ndërtim	G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	H. Transport, magazinim dhe komunikacion	I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve	P. Arsimit	Q. Shëndetësi	Të tjera
Numri	1650	13	12	834	18	402	184	13	102	13	18	41
në %	100.0	0,8	0,7	51	1,1	24	11	0,8	6,2	0,8	1,1	2,5

Shihet se ndërmarrjet e sektorëve të ndërtimit dhe industrisë përpunuese parashikojnë shumicën e vendeve të lira të punës për të ardhmen e afërt.

Figura 3 tregon përqindjet e vendeve të lira për 12 muajt e ardhshëm sipas rajoneve.

Figura 3: Përqindjet e vendeve të lira sipas rajoneve



Numri më i madh i vendeve të lira pritet të jetë në rajonet Tiranë, Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier dhe Vlorë. Këtë e shpjegon fakti që pjesa më e madhe e vendeve të lira parashikohen në ndërtim (24%) dhe industri përpunuese (51%) që janë më të zhvilluar në rajonet e lartëpërmendura.

Të dhënat mbi vendet e lira të parashikuara përmbajnë emrin e profesionit, numrin e punonjësve për t'u punësuar, dhe renditjen e tyre sipas rëndësisë (3 më të rëndësishmit).

Tabela 3.6: Përqindjet e dhjetë profesioneve më të kërkuara sipas sektorëve ekonomikë

Sektori Ekonomik	Totali	Kamariet	Shitës në dyqan	Murator për konstruksione	Konservues peshku	Prestar, rrobaqepës	Punonjës qepjeje	Operator makine qepëse	Operator makine qepëse / prodhim tekstile	Punëtor ndërtimi	Punëtor krahu
		512319	522017	712212	741116	743323	743622	826311	826318	931211	931222
A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	13	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
B. Minierë dhe gurorë	12	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C. Industri përpunuese	834	0	3	0	70	112	155	119	98	0	13
D. Furnizimi me elektricitet, gaz dhe ujë	18	0	0	1	0	5	0	0	0	0	0
F. Ndërtim	402	0	1	55	0	0	0	0	0	122	37
G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	184	14	50	0	0	0	0	0	0	10	14
H. Transport, magazinim dhe komunikacion	13	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve	102	38	1	0	0	0	0	0	0	0	0
P. Arsim	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Q. Shëndetsi	14	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të tjera	14	3	2	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	1650	55	57	56	70	117	155	119	98	132	64

Tabela 3.7: Dhjetë profesionet më të kërkuara sipas rajoneve

Rajonet	Totali i vendeve të lira të pritshme	Kamariet	Shitës në dyqan	Murator për konstruksione	Konservues peshku	Prestar, rrobaqepës	Punonjës qepjeje	Operator makine qepëse	Operator makine qepëse / prodhim tekstile	Punëtor ndërtimi	Punëtor krahu	Profesione të tjera
		512319	522017	712212	741116	743323	743622	826311	826318	931211	931222	
BERAT	15	2										13
DIBER	58	2		6						12		38
DURRES	73	9	3					17			5	39
ELBASAN	33	1		3		5				3		21
FIER	123	8	2	9		16		7		22		59
GJIROKASTER	74	3				5		25				41
KORÇE	247			14		35			98	11	7	82
KUKES	33			2						17	1	13
LEZHE	157	4	4	14	70	10				3		52
SHKODER	134	4	1	6			25	70		5		23
TIRANE	579	4	39	2		41	130			52	51	260
VLORE	124	18	8			5				7		86
Total	1650	55	57	56	70	117	155	119	98	132	64	727

Tabela 3.8 prezanton aftësitë bazë të punësueshmërisë dhe aftësitë profesionale për secilin nga dhjetë profesionet më të kërkuara.

Tabela 3.8: Aftësitë bazë të punësueshmërisë dhe aftësitë profesionale për dhjetë profesionet më të kërkuara

Profesioni Nr.	743323 Prestar, rrobaqepës		
Nr. i ndërmarrjeve	14	Nr. i punonjësve	112
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë Aftësi të lexojë, shkruajë dhe bëjë llogaritje Aftësi të përdorë teknologjinë e komunikimit dhe informacionit Aftësi organizimi dhe planifikimi Aftësi të zgjidhë probleme Aftësi të komunikimit dhe punës në grup	Aftësitë profesionale Të ketë njohuri për prerje e qepje Të ketë njohuri e aftësi përdorimi të makinës qepëse Të jetë e saktë për llogaritjet dhe për të bërë matje të sakta Të njohë vetitë e materialeve qepëse Aftësi për të ndërtuar dhe lexuar skica të veshjeve të ndryshme. Të ketë fantazi në kombinim figurash e ngjyrash	
Profesioni Nr.	743622 Punonjës qepjeje		
Nr. i ndërmarrjeve	5	Nr. i punonjësve	155
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë Aftësi të lexojë, shkruajë dhe bëjë llogaritje Aftësi të komunikimit dhe punës në grup	Aftësitë profesionale Të njohë përdorimin e makinës qepëse Të ketë vëmendje dhe përqendrim në punë Të jetë i/e shkathët në punë Të njohë mirë manovrimet e makinave elektrike Të ketë shikim të mirë	
Profesioni Nr.	826311 Operator makine qepëse		
Nr. i ndërmarrjeve	4	Nr. i punonjësve	119
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë Aftësi të zgjidhë probleme	Aftësitë profesionale Të njohë të gjitha proceset e mak. elektrike qepëse, hekurosëse, paketuese Të jetë këmbëngulës për të realizuar normën e caktuar Të ketë përvojë pune	
Profesioni Nr.	512319 Kamarier		
Nr. i ndërmarrjeve	10	Nr. i punonjësve	55
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë	Aftësitë profesionale	

	Aftësi të lexojë, shkruajë dhe bëjë llogaritje	Të jetë i shkathët dhe i saktë në prezantimin e menusë.
	Aftësi të përdorë teknologjinë e komunikimit dhe informacionit	Të ketë kujtesë të mirë
	Aftësi organizimi dhe planifikimi	Të jetë i këndshëm dhe të njohë gjuhë të huaja
	Aftësi të zgjidhë probleme	Të ketë personalitet miqësor dhe të jetë i sinqertë
		T'i shërbejë klientëve në mënyrë të kulturuar
	Aftësi të komunikimit dhe punës në grup	Të njohë rregullat e higjienës dhe artin e kuzhinës
Profesioni Nr.	522017 <i>Shitës në dyqan</i>	
Nr. i ndërmarrjeve	16	Nr. i punonjësve 57
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë	Aftësitë profesionale
	Aftësi të lexojë, shkruajë dhe bëjë llogaritje	Të ketë njohuri të kompjuterit (financa 5)
	Aftësi të përdorë teknologjinë e komunikimit dhe informacionit	Të njohë gjuhë të huaja
	Aftësi organizimi dhe planifikimi	Të ketë leje drejtimi automjeti
	Aftësi të zgjidhë probleme	Të jetë i komunikueshëm, me takt, bindës
		Të ketë aftësi menaxheriale në shitje
	Aftësi të komunikimit dhe punës në grup	Të njohë produktet dhe nevojat e tregut
Profesioni Nr.	712212 <i>Murator për konstruksione</i>	
Nr. i ndërmarrjeve	13	Nr. i punonjësve 56
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë	Aftësitë profesionale
	Aftësi të lexojë, shkruajë dhe bëjë llogaritje	Të njohë materialet e ndërtimit
	Aftësi të përdorë teknologjinë e komunikimit dhe informacionit	Të jetë i aftë të klasifikojë llojet e mureve, t'i ndërtojë ato, kryesisht guri
	Aftësi organizimi dhe planifikimi	Të lexojë skicat dhe të bëjë matje
	Aftësi të zgjidhë probleme	Të njohë e përdorë veglat dhe mjetet e punës
		Te jetë i shëndetshëm fizikisht dhe i aftë të punojë në lartësi
	Aftësi të komunikimit dhe punës në grup	Të njohë teknikat e vendosjes së llaçit, markat e çimentos dhe të dijë të suvatojë
Profesioni Nr.	741116 <i>Konservues peshku</i>	
Nr. i ndërmarrjeve	2	Nr. i punonjësve 70
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë	Aftësitë profesionale
	Aftësi të lexojë, shkruajë dhe bëjë llogaritje	Të jetë i/e shkathët
	Aftësi të përdorë teknologjinë e komunikimit dhe informacionit	Të njohë dhe realizojë filetim peshku

	Aftësi organizimi dhe planifikimi	Të punojë në grup
	Aftësi të zgjidhë probleme	Të njohë përdorimin e makinerive
	Aftësi komunikimi dhe pune në grup	
Profesioni Nr.	826318 <i>Operator makine qepëse / prodhim tekstile</i>	
Nr. i ndërmarrjeve	5	Nr. i punonjësve 98
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë	Aftësitë profesionale
	Aftësi të lexojë, shkruajë dhe bëjë llogaritje	Të përdorë makinën qepëse SINGER
	Aftësi të përdorë teknologjinë e komunikimit dhe informacionit	Të përdorë makinën dygjilperëshe, suzator
	Aftësi komunikimi dhe pune në grup	Të jetë i/e aftë të mësojë procese të ndryshme
		Të kryejë çdo proces pune qepjeje
Profesioni Nr.	931211 <i>Punëtor ndërtimi</i>	
Nr. i ndërmarrjeve	28	Nr. i punonjësve 132
Aftësitë e kërkuara →	Aftësitë bazë të punësueshmërisë	Aftësitë profesionale
	Aftësi të lexojë, shkruajë dhe bëjë llogaritje	Të jetë specialist montimi me arsim të mesëm profesional
	Aftësi të përdorë teknologjinë e komunikimit dhe informacionit	Të ketë aftësi fizike, komunikimi me klientët dhe pune në grup
	Aftësi të zgjidhë probleme	Të ketë përvojë pune
	Aftësi komunikimi dhe pune në grup	Aftësi të kryejë punët që i përkasin procesit të ndërtimit, që nga hapja e themeleve deri në përfundimin e objektit

4. TENDENCAT NË PUNËSIMIN E FORCËS SË PUNËS

4.1 Mënyrat e marrjes në punë

Të dhënat e këtij seksioni janë përdorur për të identifikuar praktikat e preferuara të marrjes në punë sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe sektorit ekonomik. Për të përcaktuar praktikat e preferuara të marrjes në punë u përdorën 6 kategori (shih Tabelën 4.1.1). Metoda e parapëlqyer duket se është “Të afërm apo miq”.

Table 4.1.1: Praktikrat e marrjes në punë sipas sektorëve ekonomikë

Sektori ekonomik	Metodat më të përdorura të marrjes në punë sipas sektorëve ekonomikë (në %)						
	Totali	Njoftime	Nga institucione arsimi, trajnimi	Nga Zyra Publike e Punësimit	Të afërm apo miq	Promovim punëtorësh brenda ndërmarrjes	Të tjera
A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	11	9	18	18	55	0	0
B. Minierë dhe gurorë	10	0	0	30	30	20	20
C. Industri përpunuese	205	9	0	41	48	1	0
D. Furnizimi me elektricitet, gaz dhe ujë	18	11	11	22	44	11	0
F. Ndërtim	176	5	2	40	44	10	0
G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	306	10	0	21	62	5	1
H. Transport, magazinim dhe komunikacion	34	21	9	24	29	18	0
I+S+T. Aktivitetet e shërbimeve	142	8	5	18	64	3	2
P. Arsimit	13	38	38	8	15	0	0
Q. Shëndetsi	18	11	33	6	44	0	6
Të tjera	31	32	23	32	35	10	0
Totali	964	10	3	28	52	5	1

Table 4.1.2: Praktikët e marrjes në punë sipas rajoneve

Rajonet	Metodat më të përdorura të marrjes në punë sipas rajoneve (në %)						
	Totali	Njoftime	Nga institucione arsimi, trajnimi	Nga Zyra Publike e Punësimit	Të afërm apo miq	Promovim punëtorësh brenda ndërmarrjes	Të tjera
BERAT	50	0	0	22	66	2	10
DIBER	30	3	10	50	30	3	3
DURRES	100	8	6	22	62	2	0
ELBASAN	50	12	4	18	54	12	0
FIER	72	4	3	42	49	3	0
GJIROKASTER	30	7	0	50	37	3	0
KORÇE	70	1	0	43	46	9	1
KUKES	25	0	0	4	96	0	0
LEZHE	50	2	0	50	44	2	2
SHKODER	70	1	1	13	81	3	0
TIRANE	349	9	3	20	50	7	1
VLORE	68	7	6	53	26	7	0
Total	964	10	3	28	52	5	1


4.2 Preferencat e punësimit (sipas moshës, gjinisë, arsimit)

Për të kuptuar më mirë strategjitë e rekrutimit të përdorura nga ndërmarrjet me qëllim për të targetuar më mirë shërbimet ndaj punëdhënësve, preferencat e rekrutimit (sipas moshës, gjinisë dhe arsimit) të ndërmarrjeve të intervistuar janë dhënë duke i ndarë kategoritë profesionale në dy grupime (shih Figurën 4.2):

- Menaxherë dhe staf profesional e administrativ
- Punonjës prodhimi dhe punësh elementare

Këto preferenca rekrutimi janë pothuajse të njëjta në të gjithë sektorët ekonomikë dhe në të gjithë rajonete.

Figura 4.2: Preferencat e rekrutimit (sipas moshës, gjinisë, arsimit)



4.3 Aftësitë më të kërkuara

Aftësitë më të kërkuara nga biznesi janë vlerësuar me pikë nga 1 (e parëndësishme) në 5 (shumë e rëndësishme). Figura 4.3.1 dhe Tabela 4.3.1 paraqesin aftësitë e konsideruara si “shumë të rëndësishme” kur kryhet rekrutimi.

Figura 4.3.1: Aftësitë më të kërkuara sipas kategorive profesionale






Table 4.3.1: Aftësitë më të kërkuara sipas sektorëve ekonomikë

Aktiviteti ekonomik	Menaxherë dhe staf profesional e administrativ													
	Totali	Të kuptuarit e dokumenteve të shkruara dhe të shkruarit qartë	Aftësi për të logaritur, lexuar dhe përdorur shifra dhe tabela	Aftësi për të mësuar si mësohet	Aftësi negociuese	Marje, interpretim dhe komunikim informacioni	Aftësi udhëheqëse	Aftësi të punës në grup	Të kuptuarit dhe përdorimi i TIK	Aftësi vendim-marrëse	Aftësi për të zgjidhur problemet	Përdorim eficient i materialeve, teknologjisë, pajisjeve dhe mjeteve	Aftësi organizative dhe planifikuese	Të tjera
A. Bujqësi, pylltari dhe peshkim	11	45	27	27	55	36	55	55	36	36	27	27	45	9
B. Minierë dhe gurore	10	50	70	50	70	60	80	50	80	70	80	40	50	0
C. Industri përpunuese	205	57	56	47	57	54	67	54	52	57	60	47	60	5
D. Furnizimi me elektricitet, gaz dhe ujë	18	33	39	50	50	56	61	39	56	67	78	56	67	6
F. Ndërtim	176	58	61	50	67	60	69	61	59	65	61	49	64	3
G. Tregti me shumicë dhe pakicë; riparime	306	63	61	50	58	57	65	59	59	56	61	49	59	5
H. Transport, magazinim dhe komunikacion	34	53	50	50	65	62	65	44	59	0	0	53	50	50
